



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18754 Prot.

Lezhë, më 22 . 12 . 2023

VENDIM

Nr. 71 , Datë 14. 12. 2023

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR NDËRTIMIN E RESORTIT TURISTIK NGA KOMPANIA "GJERGJI" SHPK

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0.91 ha** në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor privat detajohet si më poshtë:
 - 0.16 ha në pasurinë 552/6 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 62c, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit"
 - 0.01 ha në pasurinë 552/6 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 62b, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.04 ha në pasurinë 351/11 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 62c, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.06 ha në pasurinë 351/11 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 62b, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".

- 0.6 ha në pasurinë 351/11 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 61a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
 - 0.04 ha në pasurinë 351/7 zona kadastrale 2569, ngastra pyjore 61a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".
2. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku do të ndërtohet, bëhet nga shoqëria "GJERGJI"sh.p.k brenda 1 (një) viti nga koha e përfundimit të objektit.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
 4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë numër 15 datë 27.07.2023, shfuqizohet.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 18254/ Prot
Dt. 28.12.2023

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1030/19 Prot.

Lezhë më 26 . 12 .2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vërtetëqeverisjen vendore", ligjin nr .8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar ; ligjin nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; VKM nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre (ndryshuar me VKM-në nr. 267, datë 27.4.2023) si dhe në Udhezimin nr. 1 date 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.71, datë 14.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për dhënie e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private , për ndërtimin e resortit turistik nga kompania "Gjergji shpk".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

